


Kryetari



23.07.2026.

KOMITETI PËR KOMUNITETE – SKENDERAJ

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e gjashtë e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më **23.07.2026**, me fillim në ora **14:00**, në hapësirat e Zyrës Komunale në Bajë.

Në mbledhje morën pjesë anëtarët dhe të tjerët:

1. Gordana Tomić, kryesuese
2. Fatjona Tomašević, anëtare
3. Hisni Avdullahi, anëtar
4. Dejan Šapić, anëtar
5. Miftar Salihi, anëtar
6. Nedeljko Kovačević, shef i ZKKK-së
7. Fatmir Balaj
8. Përfaqësues të Policisë së Kosovës (PK)
9. Përfaqësues të UNMIK-ut

Në mbledhje u propozua ky:

REND DITE

1. Fjala hyrëse e kryesueses
2. Miratimi i rendit të ditës
3. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar (qershor 2026)
4. Mëditjet e papaguara për anëtarët e Komitetit për Komunitete
5. Punët sezonale bujqësore të mbjelljeve – raport
6. Fjalimi i përfaqësuesit të Komunës së Skenderajt
7. Raporti i Policisë së Kosovës
8. Të ndryshme

1.

Mbledhjen e hapi kryesuesja Gordana Tomić, e cila i përshëndeti të gjithë të pranishmit.

2.

Më pas, ajo e hodhi në votim miratimin e rendit të ditës, i cili u miratua njëzëri.

3.

Pastaj u hodh në votim procesverbali i mbledhjes së kaluar të Komitetit për Komunitete, të mbajtur në qershor 2026, dhe ai u miratua njëzëri.

4.

Kryesuesja Gordana Tomić: Ende nuk është zgjidhur problemi i pagesës së mëditjeve për anëtarët e Komitetit. Kemi ftuar drejtorin e Financave, por ai nuk iu përgjigj ftesës. Mëditjet nuk janë paguar që nga fillimi, ndërkohë që kjo është mbledhja e gjashtë. Ekzistojnë modele të ndryshme të pagesës; drejtori ka premtuar se pagesa do të bëhet, por asgjë nuk po ndodh. Nëse nuk bëhen pagesat, mendoj se nga shtatori nuk ka nevojë të organizohen më mbledhje. Kur dikush nuk na respekton, as ne nuk do ta respektojmë atë. E kuptojmë situatën dhe kemi heshtur deri më tani. E dimë se mund të përdorim edhe mjete ligjore. Është e pabesueshme që komuna nuk ka 300 euro në muaj për ne. Ky është një mosrespektim i plotë. Nëse mëditjet nuk paguhen, nuk ka kuptim të mbahen mbledhje, megjithëse e dimë sa i rëndësishëm është Komiteti.

Hisni Avdullahi: Pajtohem. Drejtori ka premtuar mëditje prej 70 eurosh, por deri tani nuk është paguar asgjë.

Fatmir Balaj: Kam biseduar me drejtorin. I kemi dërguar shkresë ministrisë, por nuk është miratuar. Kam biseduar edhe me kryesuesen e Kuvendit; i njëjti problem ekziston në të gjitha komunat. Drejtori i Financave do ta respektojë vendimin që pagesa prej 70 eurosh të bëhet nga buxheti i komunës. Ai ka bërë të ditur se gjithçka do të zgjidhet.

Gordana Tomić: Dua të theksoj se anëtarët e Komitetit në komunën e Ranillugut kanë ngritur padi dhe u janë paguar të gjitha mëditjet së bashku me kamatën.

Nedeljko Kovačević: Si shef i Zyrës për Komunitete, mund të them se gjithmonë kanë ekzistuar të njëjtat probleme; mëditjet, të cilat janë të detyrueshme me ligj, nuk paguhen. Ky problem duhet të zgjidhet në nivel qendror. Nuk shoh asnjë arsye pse ato të mos paguhen. Më herët ato janë paguar nga buxheti ynë për mallra dhe shërbime, i cili është i vogël, por kemi bërë përpjekje që t'u dalim në ndihmë anëtarëve.

5.

Nedeljko Kovačević: Sezoni i mbjelljeve është në vazhdim dhe gjendja është e mirë. Mendoj se problemi është mungesa e numrit të mjaftueshëm të kombajnave për procesin e korrjes.

Gjendja e rrjetit elektrik është e keqe. Moti i ligë që ka goditur këtë rajon ka rrëzuar tri shtylla elektrike dhe ka dëmtuar një automjet. Ne e kemi njoftuar rregullisht KEDS-in, por nuk kemi hasur në mirëkuptim. Në shumicën e fshatrave përreth shtyllat janë zëvendësuar.

Fatmir Balaj: Është diskutuar që të formohet një komision dhe së bashku të shkojmë në KEDS për t'ua shpjeguar situatën. Ata punojnë sipas prioriteteve, por tash e dhjetë vjet nuk kanë bërë asgjë.

6.

Fatmir Balaj: Kryetari i komunës ka shprehur dëshirën të mbajë një takim me pjesëtarët e komuniteteve, ku ata mund t'i paraqesin të gjitha problemet e tyre, qoftë në objektin e komunës në Skenderaj, qoftë në fshat.

7.

Policia e Kosovës – komandanti i nënstacionit, Tadiša Tomašević: Situata e sigurisë është e mirë. Shumica e banorëve merren me bujqësi. Është rritur qarkullimi i automjeteve për shkak të ardhjes së diasporës.

8.

Nën këtë pikë nuk pati diskutime.

MBAJTËSI I PROCESVERBALIT:

Dejan Šapić

Skenderaj, 23.07.2026

n Šapić



u Banjama



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI KOMUNAL/ASSEMBLY OF MUNICIPALITY/SKUPSTINA OPŠTINE
SKENDERAJ

Nr.

No.

Data

Data


01-060/01-0028899/26
24.07.2026

Kryetari



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Skenderajt - Opština Srbica - Municipality of Skenderaj



NJOFTIM

Për: Kuvendin e Komunës së Skenderajt
Nga: Kryesuesja e Komitetit për Komunitete

Të nderuar,

Anëtarët e Komitetit për Komunitete të Komunës së Skenderajt, në mbledhjen e gjashtë të mbajtur më 23.07.2026 në Banjë, shqyrtuan çështjen e funksionimit të këtij trupi.

U konstatua se anëtarëve të Komitetit nuk u janë paguar mëditjet e rregullta ligjore për punën e tyre në këtë trup për periudhën nga shkurti deri në korrik të vitit 2026. Si pasojë e mospërbushjes së obligimeve financiare nga ana e organeve kompetente të Komunës, anëtarët vendosën unanimitisht që të pezullojnë përkohësisht punën nga shtatori i vitit 2026.

Shpresojmë që ky problem do të zgjidhet dhe se nuk do të vijë deri te pezullimi i punës së Komitetit për Komunitete.

Me respekt,

Kryesuesja e Komitetit për Komunitete
Gordana Tomic

